



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:032013
Datë: 02.04.2024
Numri i dokumentit: 05531983

C.nr. 225/2022

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes gjyqtarit G. A, me bashkëpunëtorin profesional B. S, në çështjen kontestimore të paditëses Kompania e Sigurimeve “S...”, sh.a Dega e Kosovë me seli P. Rruga”, E. H” nr.28 ndaj të paditurit Z. (A.) Z. nga fshati M. Komuna e Gj. me objekt kontesti rimbursim i mjeteve, pas mbajtjes së shqyrtimit përgatitor e publik të datës 26.03.2024 ndërsa me datën 02.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Padia e paditëses KS “S...” me seli në Prishtinë, e datës 15.02.2022, ndaj të paditurit Z.(A.) Z. nga fshati M. komuna e Gj. **KONSIDEROHET e tërhequr**, për shkak të mungesës së palës paditëse, e cila është ftuar në mënyrë të rregullt për datën 26.03.2024, ftesën e ka pranuar por mosardhjen nuk e ka arsyetuar.

A r s y e t i m

Paditësja Kompania e Sigurimeve “S...”, me seli në Prishtinë, në këtë gjykatë më datën 15.02.2022, ka paraqitur padi ndaj të paditurit Z.(A.)Z. nga fshati M. Komuna e Gj. me objekt kontesti rimbursim i mjeteve.

Lidhje me këtë çështje kontestimore, kjo gjykatë ka caktuar seancë gjyqësore për datën 26.03.2024, në ora 13:15h, për të cilën seancë pala paditëse dhe i padituri kanë qenë e ftuar në mënyrë të rregullt, ndërsa mungesën për seancë nuk e kanë arsyetuar.

Gjykata duke e pasur parasysh se pala paditëse ka munguar në seancën e shqyrtimit gjyqësor edhe pse ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt, e cila dëshkohet përmes ftesës së dorëzimit personal për datën dhe orën e cekur si më lartë, e për të cilën seancë mungesën nuk e ka arsyetuar, prandaj duke u bazuar në dispozitën e nenit 409 paragrafi 1, të Ligjit të Procedurës Kontestimore, ku përcaktohet se “*Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet.*”, gjykata e konsideroj të tërhequr padinë e paditëses dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të lartëcekurat, e konform nenit 409 paragrafi 1, dhe 142 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK-së), u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr. 225/2022, datë 02.04.2024

Gjyqtari,
G. A

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh pas pranimi të të njëjtit, nëpërmjet kësaj gjykate